



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Abedin Kernaja** me datë **31.07.2025** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” për të pandehurin Abedin Kernaja, të caktuar me vendimin nr.112, datë 06.09.2024, të dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të pandehurit Abedin Kernaja”. Kërkuesi **Rexhë Byberi** me datë **31.07.2025** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit”. Në seancën gjyqësore të datës **01.08.2025** gjykata disponoi me bashkimin e kërkesave penale, të sipërcituara, në një të vetme.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Irena Gjoka, bazuar në nenet 112, 228, 229, 234, 237/4, 230, 249, 250, pika 1, 261, pika 3, 262, 263, pika 1, gërma “b”, 266/1 dhe 466 të K.Pr.Penale, me vendimin nr. **534**, datë **01.08.2025**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit/të pandehurit **Abedin KERRNAJA**, me objekt *“Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” për të pandehurin Abedin Kernaja, të caktuar me vendimin nr.112, datë 06.09.2024, të dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të pandehurit Abedin Kernaja”*.
2. Humbjen e fuqisë së masës së sigurimit personal shtrëngues *“arrest në shtëpi”*, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Abedin KERRNAJA**, caktuar me **vendimin Nr.112, datë 06.09.2024**, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, verifikuar me **vendimin Nr.116, datë 12.09.2024**, të po kësaj gjykate.
3. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues *“detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”*, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Abedin KERRNAJA**, akuzuar për kryerjen e veprës penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal.
4. Urdhërohet shtetasi nën hetim **Abedin KERRNAJA**, të paraqitet të Hënën e parë të çdo muaji, ora 11:00 para oficerit të policisë gjyqësore A.N, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar.
5. Pranimin e kërkesës së kërkuesit/të pandehurit **Rexhë BYBERI**, me objekt *“Kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit”*.

6. Humbjen e fuqisë së masës së sigurimit personal shtrëngues “*arrest në shtëpi*”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Rexhë BYBERI**, caktuar me **vendimin Nr.112, datë 06.09.2024**, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, verifikuar me **vendimin Nr.116, datë 12.09.2024**, të po kësaj gjykate.
7. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “*detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore*”, parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Rexhë BYBERI**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal.
8. Urdhërohet shtetasi nën hetim **Rexhë BYBERI**, të paraqitet të Hënën e parë të çdo muaji, ora 11:00 para oficerit të policisë gjyqësore A.N, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
9. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të ekzekutojë vendimin e gjykatës, nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët brenda pesë ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 01.08.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar